VENDIM
Nr. 112, datë 14.5.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DOMI TEC" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "PLEPI", ME FUQI TË INSTALUAR 2285 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10, pika 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.5.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin shoqërisë "Domi TEC" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Domi TEC" sh.p.k., me shkresën nr. 29 prot., datë 25.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 344 prot., datë 26.4.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Plepi", me fuqi të instaluar 2285 kw.

- Aplikimi i shoqërisë "Domi TEC" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d"; 4.1.4, germat "b", "c", "d", "e"; 4.1.5, germat "a" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.1.4, germa "a" (Studimi i fizibilitetit) dhe nenin 9, pika 4.1.5, germa "b" (Leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Domi TEC" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Plepi", me fuqi të instaluar 2285 kw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti